



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 133/13
Prishtinë, më 20.11.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami Albana Fetoshi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Mungoi : Sali Asllanaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli dhe Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Liridon Maksuti, Qerkin Berisha, Enis Spahiu nga Ministria e Financa, Besim Kajtazi drejtor në ZL/ZKM si dhe Jeton Oruçi koordinator i ZL-së, Sami Kurteshi-Avokat i popullit, Jashar Kastrati – Drejtor ekzekutiv në IAP-në, Ismet Krasniqi-Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi, Ruzhdi Zenelaj ekspert i jashtëm,

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 12.11.2013 dhe 13.11.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës Magjistrale Milloshevë-Mitrovicë M2, e lidhur në me Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID);
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012;
6. Shqyrtimi i Raporti nëntëmujor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregit dhe Industri;
8. Miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-080 për Lojërat e Fatit;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstaton se miratohet rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 12.11.2013 dhe 13.11.2013

Kryetarja theksoj se procesverbalet miratohen pa vërejtje .

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës Magjistrale Milloshevë-Mitrovicë M2, e lidhur në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID);

Kryetarja sqarohet se Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar PL për ratifikimin e Marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës Milloshevë – Mitrovicë M2, lidhur me Fondin e OPEC-it për Zhvillimin Ndërkombëtar. Qëllim kryesor i projektit është përmirësimi i rrugës ekzistuese në gjatësi 26.7 km duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e punësimit në Qarkun e Mitrovicës dhe Prishtinës, përmirësimin e lidhjeve rrugore dhe ngritjen e kapaciteteve që do të lehtësojë lëvizjen e njerëzve dhe mallrave duke reduktuar numrin e viktimave të trafikut urban, kohën e udhëtimit dhe ngarkesën në trafik.

Besim Beqaj theksoj se marrëveshja e arritur mes të Qeverisë dhe Fondit OPEC ku agjent financiar vepron Ministria e Financave, përgjegjëse për implementim është Ministria e Infrastrukturës. Kredia e cila merret është me afat të gjatë 20 vjeçare dhe konform vlerësimit të thesarit është e leverdishme e cila na mundëson që ta avancojmë këtë pjesë të infrastrukturës rrugore. Në vijim do të vazhdojë edhe marrëveshja e Fondit të Saudit për zhvillim e cila do të përmbyll tërë segmentin i cili konsiderohet si financim i jashtëm në shumën prej 60 mil \$ ndërsa pjesa tjetër do të mbulohet nga Qeveria.

Hykmete Bajrami vërehet se marrëveshja është e leverdishme, se është e favorshme sepse kemi një periudhë pushimi prej 5 viteve, megjithatë nuk arrihet të gjej koston totale të kësaj kredie. Plani i amortizimit bëhet në 30 kështe nga 15 Gusht 2018 mirëpo pasi që nuk mund të gjej normën e interesit e cila sigurisht është e shprehur në kosto të tjera. Dëshiroj të kuptoj se me 15 Gusht 2033 sa do të jetë kthimi total, kostoja e 20 mil?

Besim Beqaj sqarohet se në faqen 2 Neni 2 shpjegohet norma e interesit e cila është 2.75% dhe 1% që paguhet një taksë administrative për kredinë që në total është 3.75 %. E zbërthyer edhe në planin e amortizimit që nënkupton se duhet të paguhet 666.000 € për kësht. Kostoja totale do të variojë në euro konform ndryshimeve valutores të cilat mund të ndodhin në dollar e që do të jetë 7000 \$ në total duke u bërë kështu pjesë e anuiteteve që paguhet në baza të rregullta konform marrëveshjes.

Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratohet Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimin të ndërtimit të rrugës Magjistrale Milloshevë-Mitrovicë M2, e lidhur në me Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID).

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

Kryetarja theksoj se qëllimi i të këtij PL është përmirësimi i ambientit afarist dhe biznesor në Kosovë duke favorizuar kompanitë vendore në ofrimin e shërbimeve në procesin e prokurimit publik. PL ky i cili ka për qëllim të kontribuoj në ngritjen e zhvillimit ekonomik. Favorizimi i ofertuesve vendor do të vij në shprehje gjatë aplikimit të ofertës më të favorshme ekonomike dhe aplikimit të kriterëve për çmimin më të ulët të ofruar. Po ashtu ky PL nuk është në kundërshtim me traktatin për funksionimin e BE-së si dhe akteve sekondare të aplikueshme në këtë fushë, duke paraparë konkurrencë të lirë dhe të drejtë në treg. Meqenëse Kosova nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE dhe gjendet në fazën e hershme të zhvillimit të marrëveshjes së stabilizim asocimit i është njohur e drejta në fazën tranzitore të zbatimit të aquis. Periudha kalimtare sa i përket dispozitës së njejt referenca për produkte dhe kompani vendore iu është lejuar disa vendeve në rajon për periudhën tre deri në pesë vite.

Besim Kajtazi sqaroj se iniciativa për ndryshim plotësimin e këtij PL ka ardhur nga Këshilli Kombëtar për zhvillim ekonomik dhe Zyra e Kryeministrit bartëse e hartimit, kurse pjesë shqyrtuese kanë qenë të gjithë organizatat që merren me Prokurimin Publik. Procesi i plotësim ndryshimit është ndarë në dy faza: Faza emergjente që ka të bëjë vetëm me shërbimet vendore dhe faza që ndërlidhet me raportin e Komisionit të Kuvendit dhe punën e Grupit Punues. Ndryshimi aktual ka të bëjë vetëm me shërbimet të cilat ofrojnë kompanitë vendore ku përfshihen të gjitha ato që janë të regjistruara në Republikën e Kosovës. Intenca ka qenë që të përfshihen edhe produkte vendore por pas bisedave me Komisionin Evropian dhe akterët e tjerë në këtë proces kemi ardhur në përfundim që të shkojmë vetëm me dhënien e përparësive të shërbimeve nga kompanitë vendore. Kriter merret 15 % i çmimit më të ulët ndërsa synohet që me nënshkrimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit të zgjatet afati.

Naser Osmani gjatë angazhimit tim në Parlament është vërejtur se politikat institucionale kanë qenë integruese dhe kjo çka shoh sot është diskriminim në kuptimin e një konkurrence të lirë që do të sillte cilësi më të mirë. Këto politika ku i ipet përparësi vendoreve nuk i kemi tek segmentet tjera sidomos tek investimet në Kosovë. Po të ishte fjala për produkte vendore që të ketë përparësi në mesin e të barabartëve do të ishte në rregull por fjala është për kryerje të punës. Prandaj nuk e kuptoj me çfarë guximi na sjellin ndryshime të ligjeve të përkohshme që këto të ndryshohen pas disa viteve. Ne bëjmë ligje të qëndrueshme dhe jo ligje për situata, interesa të dikujt.

Latif Gashi sqaroj se më herët ka pasur vërejtje ku shumë kompani të huaja kanë marrë punë në Kosovë.

Hykmete Bajrami vlerësoj se përfaqësuesit nga Zyra e Kryeministrit theksuan se janë të vetëdijshëm se ky plotësim dhe ndryshim i ligjit nuk është komplet në përputhje me legjislacionin e BE-së. Ndërsa ju kryetare lexuat një deklaratë nga institucionet e njëjta që dhe prishin punë por ka praktika të tilla derisa jemi në fazën fillestare të angazhimit, ndoshta është cituar gabim. Duhet të nisemi nga ajo se a do të marrim praktika të mira apo të këqija. Ligji ka ardhur pa analizë dhe evidenca statistikore, të cilat do t'a mbështesnin këtë plotësim dhe ndryshim. Jam e interesuar të kuptoj sa është përqindja e kompanive të huaja të cilat janë fituese të tenderëve nga agjencionet buxhetore kontraktuese në Kosovë? Poashtu siç u potencua nga deputeti Osmani se nuk flitet për prodhues vendor por ofertues vendor, duke favorizuar kështu kompanitë që marrin produkte nga vendet fqinje dhe më të largëta për t'i bërë konkurrencë kompanive vendore. Pra, duhet të sqarohet se a është fjala për prodhues vendor apo ofertues vendor? Efekti i kësaj do të ishte zero sepse me hyrjen e ligjit në fuqi do të detyronim kompanitë e huaja që do të donin të merrnin pjesë në tenderët tonë t'i regjistronin kompanitë pa asnjë kosto, kosto kjo e cila është zero. Sqaroj se kompanitë vendore kanë më shumë problem me ligjin e prokurimit sesa konkurrenca jo fer

e cila mund të i'u bëhet nga kompanitë e huaja. Bizneset ankohen se nuk mund të marrin punë nga institucionet pa paguar ryshfete, një përqindje që varion nga 10-20 %. Duhet ta ndryshojmë/plotësojmë ligjin në pjesën përmbajtësore dhe të zvogëlohen hapësirat ligjore për të mos fituar tenderë në mënyrë jo të ndershme. Kemi praktika që mund të merret nga vendet e zhvilluara për përmirësimin e ambientit të biznesit.

Xhevdet Neziraj theksoj se së bashku me zyrtarët e Qeverisë kemi analizuar ligjin dhe së shpejti raporti të dal në mënyrë që merren parasysh vërejtjet dhe sugjerimet që janë dhënë nga institucionet që zbatojnë këtë ligj në mënyrë që kur të vij në plotësim ndryshim të mos përsëritet. Është mirë që tani të hyjnë plotësim ndryshimet, të bëhet një ligj më efikas dhe praktikë. Vërejtja e cila është bërë nga një tryezë është që sa më shpejt të bëhet prokurimi i centralizuar dhe fillimi i zabtimit të prokurimit elektornik.

Kryetarja sqaroj se gabimisht ka thënë se ky projektligji nuk është në kundërshtim me traktetet e BE-së, e që në faktë ideja është se nuk është në pajtim të plotë me legjislacionin e BE-së

Hykmete Bajrami theksoj se nuk mund të themi mund të jetë, ose është ose nuk është.

Latif Gashi pyet për vonesën e nxjerrjes së ligjit pasi që ky ligj është dashur të nxirret më herët duke i larguar vërejtjet e opozitës se i gjithë buxheti për projektet e mëdha kapitale është marrë nga firmat e huaja siç është ajo e autostradës. Konsideroj se ky ligj duhet të përkrahet.

Naser Osmani pyet se cili shtet i rajonit e ka të rregulluar kështu?

Besim Kajtazi sqaroj se i gjithë procesi i diskutimeve dhe hartimit të ndryshim plotësimit të ligjit për prokurim publik lidhur me përparësinë e produkteve dhe shërbimeve ka qenë transparent ku janë përfshirë të gjitha institucionet, Komisioni Evropian. Ndërsa shtetet që e kanë të ngjashme janë Serbia, Bosnja, Maqedonia. Duhet cekur se Kosova nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në, si e tillë nuk kemi obligim ndaj BE-së në kuptimin përafrimin 100%. Pas nënshkrimit të marrëveshjes ne marrim obligime se deri në cilën shkallë dhe si të bëhet përafrimi.

Naser Osmani pyet se a mundet një kompani e huaj të tenderoj në Kosovë pa u regjistruar?

Latif Gashi konsideroj se ky ligj është i rëndësishëm dhe Qeveria është vonuar në nxjerrjen e tij. Poashtu është befases fakti se si mundet që opozita ta kundërshtoj një ligj i cili është në favor të komunitetit, kompanive tona.

Kryetarja theksoj se të drejtë ofertimi sipas ligjit e kanë edhe kompanitë e huaja, citoj nenin 60.

Hykmete Bajrami argumentet tona kundër këtij propozimi nuk janë për të qenë kundër kompanive vendore. Kemi qenë kundër përjashtimit të kompanive vendore në projektet më të mëdha. Mendojmë se favorizimi dhe konkurrenca e drejtë në këtë sektor bëhet vetëm duke luftuar korrupsionin, i cili i vë në dis favor firmat. Ky është terren i përgaditur për kompani të caktuara. Kompanitë e huaja nuk do ta kenë të vështirë ta regjistrojnë biznesin në Kosovë sepse procedurat janë lehtësuar, nuk ka kosto financiare për regjistrim të biznesit. Mirëpo firmat tona e kanë më të vështirë ato të cilat nuk janë kredibile për të gjetur partner ndërkombëtar për të konkurruar në tenderë. Sërish kërkoj të di sa është përqindja e kompanive të huaja që fitojnë tender dhe cilat janë rezultatet e pritshme të këtij projektligji. Nëse kemi masa për favorizim të prodhimit vendor do të jemi për. MF dhe ATK ende nuk a kanë implementuar projektin e arkave fiskale, kemi konkurrencë jo lojale për shkak të kësaj.

Latif Gashi vlerësoj se po bëhet fushatë zgjedhore, propozoj që të bëhet një grup punues me anëtarë Naser Osmani dhe Hykmete Bajrami. Nuk janë duke u analizuar nenet si duhet.

Pas diskutimeve Komisioni me Shtatë vota Për (Safete Hadergjonja, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Kransiqi, Sevdije Lama, Duda Balje) Dy kundër (Naser Osmani, Xhevdet Neziraj) dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

5. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012

Kryetarja njoftoi se në bazë të nenit 27 paragrafi 1 të ligjit për avokatin e popullit, avokati i paraqet raport Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 Mars për çdo vit kalendarik. Në raport për vitin 2012 janë pasqyruar të hyrat nga buxheti i Republikës së Kosovës, shpenzimet si dhe planifikimi i buxhetit sipas kategorive. Vërejmë se 91.79 % të mjeteve janë shpenzuar nga avokati i popullit si dhe donacionet të cilat i ka pasur brenda periudhës së caktuar të shpenzuara në 55%.

Sami Kurteshi sqaroi se përveç të dhënave të prezantuara në raport ka pasur edhe auditim, poashtu disa ndryshime në mjete financiare në kuptimin e reduktimit të shpenzimeve. Shpenzimet e reprezentacionit janë larguar. Shpenzimet për telefon janë zbritur për 70%.

Kryetarja kërkoi sqarim se pse raporti i cili është paraparë me ligj që të dorëzohet më 31 Mars është dorëzuar në muajin e dhjetë. Ku qëndrojnë arsyet e vonës së raportimit? Poashtu kemi vërejtur se në raport pothuajse në të gjitha kategoritë e shpenzimeve ka lëvizje nga ajo që është planifikuar. Disa nga këto shpenzime janë: shpenzimet e udhëtimit janë shpenzuar 11.37% më shumë sesa është planifikuar, shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit 4.38%, tek mëditjet e udhëtimit zyrtar janë shpenzuar 84.16%. Shpenzimet e telefonisë mobile janë shpenzuar deri 68.85% më shumë nga ajo e planifikuar etj.

Sami Kurteshi sa i përket shpenzimeve të jashtme kontaktet e institucionit janë duke u shtuar dhe pres që vitin e ardhshëm të rriten më shumë. Kemi marrë obligime të reja në konferenca ndërkombëtare, mendoj se duhet të bëhet edhe një planifikim për anëtarësimin në ato rrjete. Kurse sa i përket shpenzimeve të brendshme është rritur numri i personave të cilët i vizitojnë komunat nëpër Kosovë. Telefonia mobile është shpenzuar më shumë për shkak të mosplanifikimit të mjeteve për zëvendës të cilët shpenzimet mujore për telefoni i kanë pasur 100€.

Latif Gashi konsideroj se raporti është teknikisht i përgaditur mirë, por ka edhe të metat e veta. Ajo që më intereson është se me buxhetin e planifikuar për paga dhe mëditje janë paraparë 48 pozita kurse në gjashtë mujorin e parë janë punësuar 44 punëtor. Pse nuk janë rekrutuar këto pozita të planifikuara si dhe mjetet e parapara për kategorinë paga dhe mëditje ku janë shpenzuar?

Xhevdet Neziraj vlerëson se planifikimi buxhetor dhe realizimi të jetë i përpiktë. Është vërejtje për drejtorin e buxhetit sepse duhet të realizohet aq sa është planifikuar pa tejkalime.

Sami Kurteshi sqaron se raporti është vonuar për shkak të problemeve që i kemi pasur brenda

institucionit siç është puna e përkthimit të raporteve dhe reformat e tjera brenda institucionit që është dashur të absorbohen rastet të cilat për gjashtë muaj kanë qenë afër 60% më shumë sesa vitin e kaluar. Sa i përket planifikimit duhet të bëhen një planifikim më i mirë, një margjinë e fleksibilitetit ku ne mund të lëvizim. Institucioni ka marrë vendim që të zbriten shpenzimet e telefonisë për personat politik, udhëheqës. Problemi i rekrutimit është problem në vete.

Jashar Kastrati sqaroi se një ndër arsytet që skemi arritur të bëjmë punësimin e punëtorëve është se ka munguar masa monetare për paga, ndarja e buxhetit ka qenë për vitin 2011 kurse deri në vitin 2011 nuk kemi pasur postin e zëvendësit. Masa monetare ka qenë e njëjtë për 2012 në raport me vitin 2011, kemi pasur kufizime për punësim të personelit civil për shkak se masa monetare nuk ishte e mjaftueshme për të bërë punësimin e 48 punëtorëve. Në maj të vitit 2012 është bërë kërkesa në MF, Kuvend dhe është ndarë masa monetare e mjaftueshme, deri në fundvit do të plotësohet ashtu siç është paraparë në raport.

Latif Gashi realisht institucioni i avokatit të popullit është i angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, institucion që do të jetë shembull për qytetarët e Kosovës. Ky institucion që nga themelimi e deri më sot me probleme të brendshme, vonohet në raportim, ka probleme me përkthime, raporte brenda institucionit. Bindja ime është se avokati i popullit nuk ka mundësi ti mbrojë të drejtat dhe liritë e qytetarëve përderisa i ka të gjitha këto probleme. Kërkoj që të punohet më mirë, të raportet më mirë.

Sami Kurteshi mendoi se vlerësimi është krejtësisht i padrejtë, prej hyrjes së këtij avokati numri i ankesave është shtuar në 200%, nëse flitet për besimin e qytetarëve në institucione cili institucion ka rrit vëllimin për 200%? Institucioni i avokatit të popullit ka probleme të ngjashme sikurse institucionet e tjera. Por jo të flitet edhe për bindjen e qytetarit është e padrejtë.

Latif Gashi sqaroi se shumë herë keni pasur probleme, i gjithë mandati ka shkuar duke u marrë me çështje të brendshme, jeni ankuar se punëtorët me pozita më të ulëta kanë paga më të larta se ju. Si komision kemi bërë stabilizimin e pagës suaj, tani deklaroni se keni probleme me përkthimin e raporteve dhe si rezultat i kësaj është vonuar raporti.

Sami Kurteshi theksoi se problem i pagave ka qenë problem i shtetit i cili nuk i ka alokuar paga institucionit. Avokati i popullit nuk i ka ndaluar pagat por i ka ndalur Kuvendi dhe Qeveria. Avokati i popullit dhe zëvendësit marrin paga të jashtëligjshme.

Naser Osmani sqaroi se paga juaj si avokat është e ligjshme. Pagë e cila është rekomanduar nga komisioni për buxhet dhe financa, që kalon në procedurë dhe bëhet në formë të ligjit me ligjin. Propozoj që raporti të aprovohet dhe të diskutohet në seancë, kurse ne të kërkojmë ndonjë auditim të performancës.

Sami Kurteshi theksoi se paga që marrim ne nuk është e caktuar me ligj jo me ligj të buxhetit sikurse çdo pagë tjetër. Është caktuar me vendim të kryesisë së Kuvendit. Nuk e di a është auditori i përgjithshëm matës i performancës. Ne kemi bërë një matje të performancës funksionale që nuk e bënë asnjë institucion. Nuk ka ngjarë që auditorit të mos i ofrohet ndonjë dokument i institucionit. Nuk pajtohem që dikush në mënyrë anonime të kërkoj auditimin e institucionit përmes prokurorisë dhe policisë për krime ekonomike.

Kryetarja sqaroi se paga juaj është propozuar nga KBF, ka shkuar në Kryesi e cila e ka dërguar në Kuvend ku është miratuar me votën e deputetëve, është bërë pjesë e ligjit të buxhetit. Auditori gjeneral ka për obligim sipas ligjit të bëjë raporte të rregullsisë dhe raporte të performancës. Nënkryetari propozoj që

të bëhet një raport të performancës. Po ashtu kërkoj përkrahjen e deputeteve për propozimin tim që t'ia japim edhe një rekomandim avokatit të popullit që ti përforcoj kapacitete planifikuese brenda institucionit.

Latif Gashi qëllimi është i mirë, jam dakord me propozimin e deputetit Osmani, nuk jam dakord që institucioni i avokatit të hetohet dhe shantazhohet me forma tjera. Kërkoj të tërhiqet fjala juaj, ngase duhet të jesh më i përgjegjshëm ndaj fjalëve tuaja. Ju thatë se merrni pagë të paligjshme, si guxoni ta thoni këtë duke e ditur se nuk guxon të merrni një pagë të tillë?

Sami Kurteshi theksoj se nuk jam penduar kam dhënë arsyetimet e hapura, kemi bërë tejkalime në disa kategori. Jam kundër hapjes së hetimeve të fshehta nga prokuroria dhe policia dhe jo kundër auditorit, matjes së performancës në mënyrë të ligjshme pa asnjë rezervë.

Xhevdet Neziraj sqaroj se avokati duhet të kuptoj se ne secilit agjencion i kërkojmë një auditim të performancës .

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

1. Të miratohet Raporti vjetor financiar i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012.
2. Kuvendi në pajtim me nenin 3.7 të Ligjit nr.03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, të kërkojë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të kryej auditimin e performancës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe raportin e auditimit t'ia dërgojë Kuvendit.
3. Institucioni i Avokatit të Popullit të ngrit kapacitetet e brendshme profesionale për planifikimin më të mirë të shpenzimeve buxhetore.

6. Shqyrtimi i Raporti nëntëmujor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013

Kryetarja theksoj se Kuvendit si çdo herë ka paraqitur raportin me shpenzime të detализuara. Megjithatë gjatë analizës së raportit kemi vërejtur disa lëshime që janë bërë, të cilat duhet të përmirësohen.

Ismet Krasniqi para jush paraqes raportin e shpenzimeve të nëntë mujorit për vitin 2013, mendojmë se raporti është shumë i detalizuar. Dua të sqaroj se këtë raport po e ndjek mos prezantimi i pagave në muajin janar, tek kategoria e pagave kemi një përqindje të ulët të shfrytëzimit të buxhetit. Buxheti i ndarë për këtë nëntë mujor është 78% ku janë të përfshira kategoritë kryesore. Kane ndodhur dy aktivitete -furnizimi me pajisje për dy salla në shumën prej 67.000€, kamera dhe dëgjuese për gjithë objektin 55.000€, monitor për vendosjen për salla në vlerë 4.000€. Faza e dytë e I parlamentit është 99.000€. Është bërë edhe pagesa projektit kryesor për ndërtesa 49.000€ që në total është rreth 300.000€. me gjithë këto investime arrihet niveli i kategorisë së investimeve kapitale në 72%.

Latif Gashi më intereson pse investimet kanë një përqindje kaq të ulët 34.67% ? Poashtu të sqarohet edhe kategoria për përfituesit individual në vlerë prej 500€, kush janë përfituesit individual? Kërkoj nga Administrata që të mos i jepen mjete atyre që jetojnë në Prishtinë për shpenzime.

Naser Osmani theksoj se tek faqja zyrtare e Agjencisë antikorruption në hapje të faqes shkruan korrupsioni dhe emrat e deputetëve mendoj se duhet të hiqet fjala korrupsioni.

Ismet Krasniqi sipas ligjit për çështje jozyrtare më është dashur që të prezentoj dokumentacionin për shpenzimet e deputetëve në kategorinë e udhëtimit. Janë 75 deputet, procedimi i pagesa është bërë në bazë të kërkesave individuale apo te grupeve parlamentare të cilat kanë sjell dëshmi për vendbanimin e përhershëm të deputetit. Nuk mund ta refuzojmë një kërkesë të deputetit i cili sjell dëshmi për shkak se vendimi i Kryesisë është i thjeshtë. Kompensohen shpenzimet e deputetëve për ardhjen në takimet e komisioneve dhe seanca plenare. Le të shqyrtojë Komisioni vendimin e kompensimit të rrugës por administrata se ka atë kompetencë.

Kryetarja sqaroi se në bazë të dokumentacionit i takon e drejta e kompensimit.

Latif Gashi dua të sqaroi se kemi deputet që asnjëherë nuk shkon në vendit të cilin e ka paraqitur në dokument dhe merre kompensim.

Ismet Krasniqi sqaroi poashtu se tek shpenzimet individuale është participim i shpenzimeve të varrimit të një punëtorit të cilit ka vdekur, i është paguar arkivoli.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Pas diskutimeve Komisioni me një votë Kundër (Albana Fetoshi) nxorri këtë

Rekomandim

Projektligjit nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe amendamenteve të Komisionit funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

8. Miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-080 për Lojërat e Fatit

Kryetarja theksoj se raportin e keni marrë me kohë, gjatë punës është angazhuar eksperti Ruzhdi Zenelaj si dhe psikologja Gyltene Dërguti.

Naser Osmani konsideroj se jemi mundur që të bëjmë një vlerësim të zbatueshmërisë së ligjit. Të gjeturat që janë pjesë e raporti që ka të bëjë me lotarinë e Kosovës, ATK-së dhe Doganat janë serioze. Pjesë e Raportit është edhe analiza e psikologes që përfshin ndikimin e lojërave të fatit në familje, pastaj efektet në shëndetësi, efektet financiare, në ligj etj.

Ruzhdi Zenelaj prezentoj raportin, të gjeturat, procesin e monitorimit si dhe vizitat në ATK, Dogana dhe Lotarinë e Kosovës.

Latif Gashi vërejtë se raporti është i mirë dhe profesional.

Kryetarja propozoi që të futet si rekomandim që në vitin e ardhshëm të bëhet plotësim ndryshimi i ligjit.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin nëntëmujor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013

9. Të ndryshme

Kryetarja njoftoj se KDI ka kërkuar nga KBF që të jetë pjesë e takimit i cili do të mbahet me dt. 26 Nëntor 2013 duke filluar nga ora 10:00 në Hotel Sirius në Prishtinë.

Latif Gashi theksoj se megjithëse si grup punues puna ka përfunduar më herët mirëpo raporti është vonuar për shkak të përpilimit.

Kryetarja njoftoj se nga GIZ janë angazhuar tre ekspert që do të bëjnë analizën e buxhetit në fusha të caktuara. Poashtu si ekspert kemi angazhuar edhe Teki Shalën që do të jetë pjesë e grupeve punuese.

Propozimi për angazhmin e Teki Shalës si ekspert i jashtëm që do të paguhet nga buxheti i Komisionit, miratohet njëzëri.

Mbledhja përfundoi: 13:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj